



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 24.04.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në
orën 13:50 dhe mbaroi në orën 14:20.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Klodian Kreçi, Specialist IT pranë KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 24 prill 2020 fillon me prezantimin e pikës së rendit të ditës nga Kryetarja e Këshillit, zonja Naureda Llagami e cila ia jep fjalën zotit Toska për relatimin e relacioneve përkatëse.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toka fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht do të hidhet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, më pas Gjykata e Apelit Korçë.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale me objekt: Dërgimin e çështjes në gjyq, regjistruar në emër të disa shtetasve, 3 prej të cilëve kanë bërë kërkesë për “Zëvendësim mase sigurimi”, kërkesa këto që sipas ligjit duhet të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar që shqyrton dërgimin e çështjes në gjyq, pra çështjen kryesore.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e këtyre 4 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: z. Petrit Çomo si dhe gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht : z. Bedri Qori; z.Kreshnik Omari; z. Kastriot Gramshi; znj. Shefkije Demiraj; znj. Ardiana Bera; znj. Migena Laska; z. Ahmet Metalia dhe z. Arben Micko.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik, i cili mundësohet nga specialistë të Misionit EURALIUS dhe nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Vjollca Spahiu, i cila caktohet për të gjykuar çështjen kryesore të veçantë si dhe tre kërkesat për “Zëvendësim mase sigurimi” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z. Ridvan Hado, gjithashtu të përjashtohet nga shorti edhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë që është caktuar më herët gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vitin 2020, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: znj. Zegjine Sollaku.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Elona Toro, e cila caktohet për të

gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë.

Çështje jashtë rendit të ditës mbi një shqetësim të ngritur nga zoti Bici.

Pas shqyrtimit të pikës së rendit të ditës merr fjalën *zoti Medi Bici* i cili vë në dijeni anëtarët e Këshillit se me kërkesën e Misionit USAID është mbledhur Komisioni i Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë dhe në këtë takim është propozuar ndryshimi i një pike të Memorandumit në lidhje me nënshkrimin, duke përjashtuar përfaqësuesin e Gjykatës së Lartë dhe duke bërë të mundur kështu nënshkrimin e Memorandumit nga dy palë (KLGJ dhe USAID). Zoti Bici gjithashtu shton faktin se kjo marrëveshje nuk u arrit për shkak se disa nga anëtarët e Komisionit nuk ishin dakord. Zoti Bici i kërkon Këshillit që të t'i japë precedencë çështjes për materialin që i përket shkresës së Presidentit të Republikës ose të vijohet me nënshkrimin e Memorandumit, kjo pasi është kërkuar edhe nga zonja Ann Trice nëpërmjet një e-maili.

Në vijim të fjalës së zotit Bici, merr fjalën *zoti Toska* i cili edhe ai vë në dijeni Këshillin se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës po merret me materialin që i përket shkresës së Presidentit të Republikës, material i cili do t'u vihet në dispozicion anëtarëve ditën e sotme. Përtej kësaj, sipas zotit Toska edhe Gjykata e Lartë duhet të jetë palë në nënshkrimin e Memorandumit dhe propozimi i tij do të ishte që e gjithë trupa e Gjykatës së Lartë të nënshkruajnë Memorandumin.

Merr fjalën *zonja Kadi* e cila është e mendimit që lidhur nga shqetësimi i përcjellë nga zonja Ann Trice kjo çështje duhej të futej për diskutim. Shqetësimi i zonjës Kadi nuk është tek nënshkrimi nga e gjithë trupa e Gjykatës së Lartë por tek mesazhi që jepet dhe propozon që duke qenë se materiali është gati dhe relacioni vjen ditën e sotme, atëherë Këshilli nuk ka pengesë për ta trajtuar këtë çështje ditën e hënë. Gjithashtu zonja Kadi është e mendimit që fillimisht duhet të zgjidhet çështja e zotit {...}.

Në përgjigje *zonja Llagami* shprehet se kjo kërkesë aktualisht ka ardhur në e-mail vetëm nga Misioni USAID dhe jo nga Komisioni. Prandaj për të respektuar rregullat,

propozimet për mbledhje plenare duhet të vijnë nga Komisioni dhe si e tillë, zonja Llagami fton anëtarët e Komisionit që të sjellin propozimet përkatëse për mënyrën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe më pas të përfshihet në rendin e ditës brenda ditës.

Zonja Kadi mendon se ka një problem procedural pasi, shumica në Komision është e mendimit që nuk mund të vihet me një propozim në Këshill por duhet të zgjidhet njëherë çështja e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe duke qenë në pakicë, nuk mund të vijë me propozim në Këshill për të ndryshuar situatën. Sot u ngrit si shqetësim, -shton zonja Kadi, -pasi kjo është një emergjencë që vjen nga zonja ambasadore dhe duke qenë që shumica e Komisionit nuk ka propozim për ndërhyrje është dakord që të vijë iniciativa tjetër në Këshill dhe të shqyrtohet.

Edhe një herë rimerr fjalën **zonja Llagami** duke u përgjigjur që Komisioni duhet të vijë me një qëndrim që më pas të futet çështja për diskutim në rendin e ditës.

Më pas merr fjalën **zoti Toska** i cili i drejtohet zonjës Kadi duke shprehur se nëse Komisioni mendon që kjo çështje duhet të trajtohet në Këshill, atëherë Komisioni duhet ta sjellë për trajtim si çështje dhe nëse ky Komision mendon se Këshilli nuk duhet të ndërhyjë, atëherë s'ka pse të vazhdohet me diskutimet por thjesht të pritët të vijë çështja e zgjedhjes së problemit nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Edhe pse Komisioni ka qëndrime të ndryshme brenda tij, kjo s'do të thotë që çështja nuk duhet të vijë në Këshill, -shton zoti Toska.

Zonja Kadi është dakord që edhe pse këtë gjë e mendon vetëm pakica e Komisionit, atëherë Komisioni do e sjellë për procedurë propozimin e zotit Bici të diskutohet në Këshill.

Edhe **zonja Shehu** jep mendimin e saj mbi çështjen e ngritur si shqetësim dhe propozon që relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe çdo propozim tjetër i mundshëm që mund të vijë nga Komisioni i Përkohshëm mbi evadimin e çështjeve në

Gjykatën e Lartë, të trajtohen në të njëjtën mbledhje plenare pasi çështjet kanë lidhje juridike dhe logjike me njëra-tjetrën dhe zgjidhja e njëres do të ndikojë tek zgjidhja e çështjes tjetër.

Sa i përket propozimit të zonjës Shehu, **zoti Toska** është i mendimit që do të ishte gabim nëse këto dy çështje trajtohen së bashku me njëra-tjetrën dhe sugjeron që Memorandumi mos të kushtëzohet nga çështja e trajtimit të rastit të gjyqtarit {...} nga Këshilli.

Rimerr fjalën **zonja Shehu** për të saktësuar atë çka tha më lart. Zonja Shehu është e mendimit që të trajtohen në të njëjtën mbledhje pasi nëse Këshilli nuk arrin në atë mbledhje të marrë një vendim për çështjen {...}, atëherë kjo nuk e pengon më zgjidhjen e çështjes së Memorandumit dhe të kalohet në trajtimin e çështjes tjetër.

Zonja Ukperaj është i të njëjtit mendim me zotin Toska sa i përket trajtimit të dy çështjeve të ndara nga njëra-tjetra dhe më pas sugjeron që duhet të vijohet me prioritet nënshkrimi i Memorandumit dhe ky nënshkrim të bëhet nga të katër anëtarët e Gjykatës së Lartë.

Në vijim të fjalës së zonjës Ukperaj dhe **zonja Luli** mendon që Komisioni i Përkohshëm duhet të sjellë përpara Këshillit dy propozimet: nëse ky Memorandum duhet të firmoset vetëm nga Këshilli dhe USAID-i dhe propozimi tjetër, nëse Memorandumin do ta firmosin edhe përfaqësuesit e Gjykatës së Lartë dhe, në varësi Këshilli do të vendosë duke mos e lidhur çështjen me atë çka do të sjellë në Këshill Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndërsa **zoti Toro** mbështet propozimin e zonjës Shehu duke u shprehur se të dy këto çështje kanë lidhje njëra me tjetrën dhe duhet të shqyrtohen brenda të njëjtës ditë.

Në përfundim të këtyre diskutimeve dhe shqetësimeve nga ana e anëtarëve. Këshilli bie dakord që fillimisht Komisioni i Përkohshëm për evadimin e çështjeve në

Gjykatën e Lartë të sjellë propozimet përkatëse (relacion dhe projektvendim) të cilat më pas do të futen direkt për trajtim në rendin e ditës.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor